

**NJOFTIM
PËR MBLEDHJEN E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME
TË AKSIONERËVE TË "BANKA CREDINS" SH.A.**

Për: Z/Znj. _____ (Aksionar/Përfaqësues/e i/aksionarit _____)

Ju njoftojmë se ditën e Mërkurë datë 5 Shkurt 2020 ora 12:00 në ambientet e " BANKA CREDINS" SH.A., në adresën Rr. "Vaso Pasha" Nr. 8, Tiranë, do të zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të "BANKA CREDINS" SH.A me rend dite si më poshtë:

1. Dhënia e miratimit për shitjen e pasurisë së paluajtshme në pronësi të Banka Credins, realizuar sipas kontratës së shitjes Nr.12417 Rep., Nr. 4168 Kol., datë 31.12.2019. Pasuria e Paluajtshme është Pasuria me regjistrin hipotekor numër 518, date 03.12.2012, ne zonën kadastrale 3028, me adresë 3028, Poro, Vlorë, me sipërfaqe 27.35 ha., e cila është regjistruar në pronësi të Bankës Credins si rezultat i ndjekjes së procedurave përmbarimore.
2. Aprovimi i veprimeve të Drejtorisë për nënshkrimin e kontratës së shitjes për transferimin e pronësisë për pasurinë e përmendur ne piken 1.
3. Propozim për miratimin e ndryshimeve ne Statutin e Banka Credins sh.a.
4. Propozim për riemërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues Z. Jonas Hasselrot.
5. Ngarkohet Drejtoria të kërkojë miratimin pranë Bankës së Shqipërisë, për riemërimin e Anëtarit të Këshillit Drejtues Z. Jonas Hasselrot dhe të bëjë regjistrimet përkatëse në përputhje me Ligjin.
6. Propozim për miratimin e emetimit të ri të obligacioneve afatgjata të konvertueshme në aksione të zakonshme të Bankës Credins sh.a.
7. Për sa me sipër, ngarkohet Drejtoria të bëjë njoftimet, të kërkojë miratimet kur është rasti dhe të bëjë regjistrimet përkatëse në përputhje me Ligjin.

Jeni të lutur të paraqiteni. Ju Faleminderit.

Maltin KORKUTI
DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Tiranë më 15.01.2020

Sqarojmë se:

Referuar Statutit të shoqërisë dhe Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare» Aksionarët kanë këto të drejta dhe detyrime:

- Aksionarët, të cilët zotërojnë aksione, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë ose një përqindje më të vogël, të parashikuar në statut, mund t'u drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë komunikimin me postë elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose, jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë, të kërkojnë përfshirjen e çështjeve të caktuara në rend të ditës. Në kërkesë duhet të jepen arsyet dhe objektivat, si edhe çështjet për të cilat duhet të marrë vendime asambleja e përgjithshme. Nëse kërkesa nuk është pranuar, këta ortakë kanë të drejtë të thërrasin asamblenë e përgjithshme e të vendosin çështje në rendin e ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 137 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare»

- Nëse asambleja e përgjithshme, në kundërshtim me sa më sipër, nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk përfshihet në rendin e ditës, secili prej aksionarëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

a) të ngrëjë padi në gjykatë për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse organet drejtuese nuk përmbushin kërkesat e tyre brenda 15 ditëve;

b) t'i kërkojnë shoqërisë blerjen e aksioneve të zotëruara prej tyre, sipas nenit 133 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare».

- Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, dhe thirrja u është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, në të njëjtat mënyra, me të cilat është kryer njoftimi i parë.

- Një aksionar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një prokure nga një aksionar tjetër, apo nga një person i tretë.

- Administratorët dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.

- Prokura, mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

- Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të aksionarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të aksionarit përfaqësuar.

- Asambleja merr vendimet nëpërmjet votimit të hapur.

- Për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës apo administratorëve, asambleja e përgjithshme vendos me votim të fshehtë, nëse kjo mënyrë votimi kërkohet nga aksionarët, të cilët zotërojnë një numër aksionesh, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

- Kopje të dokumenteve dhe projekt-vendimeve bashkëlidhur me këtë njoftim do të gjeni edhe pranë Selisë së shoqërisë, nëpërmjet një kërkesë me shkrim të depozituar pranë shoqërisë "Credins Bank" sh.a.